



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-01/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-4812/14
Br.Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	16.12.2014
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK- 03-3758/14, për z. Murat Meha – Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-3758/14, për z. Murat Meha – Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Meha, është hetuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat N.P. "M & M".

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Meha është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat, mirëpo ai ka kërkuar që vullnetarisht ta mbyllë këtë biznes.

Ndërkohe ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 4542/14) me të cilën vërtetohet se ka mbyllur biznesin privat N.P. "M & M". Me këtë z. Meha ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

